



6507/45
Konkurs
Prishtinë, 24.10.2017

Kolegji UBT në Prishtinë, duke vendosur në pajtim me dispozitat e neneve 8 e 10, paragrafi. 2, pika 2.2. të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, dispozitat e nenit 26 të Ligjit për Arsimin e Lartë të Kosovës Nr. 04/L-037, nenit 3, pika 3.1 të UA 20/2016 mbi Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, dhe dispozitat e nenit 49 paragrafi 1 të Statutit, Rektori i Kolegjit UBT

Shpallë KONKURS

për angazhimin e personelit akademik në Programet e Kolegjit UBT Prishtinë

I. PROGRAMI I STOMATOLOGJISE

1. Specialist në ortopedin e nofullave - 1 ekzekutues;
2. Specialist në stomatologjinë e fëmijëve dhe preventivës – 1 ekzekutues;
3. Specialist i sëmundjeve të dhëmbit me endodoncion – 1 ekzekutues;
4. Specialist në protetikën stomatologjike – 1 ekzekutues;
5. Specialist në kirurgjinë orale – 1 ekzekutues;
6. Specialist në paradontologji dhe mjekësi orale – 1 ekzekutues;
7. Asistente të stomatologjisë – 6 ekzekutues;

II. PROGRAMI I INFERMERISE

1. Asistent për lëndën Kujdesi Paliativ – 1 ekzekutues;
2. Asistent për lëndën Mjekësia Interne në Infermieri – 1 ekzekutues;

Kandidatët të cilët aplikojnë për asistentë duhet të plotësojnë kushtet si në vijim:

1. Të kenë të përfunduar studimet Master ose magjistraturë në fushën përkatëse;
2. Të kenë notën mesatare jo më të ulët se 8 (tetë);
3. Të kenë së paku 2 vite përvojë pune në fushën akademike;
4. Të ofrojë dëshmi për punë kërkimore shkencore konform nenit 50 të Statutit të Kolegjit UBT;
5. Për konkursin e shpallur, kapitulli 1, pozitat 1 – 6, kandidati të dëshmojë përfundimin e specializimit nga lëmi përkatës, ndërsa për pozitën 7 të njëjtit kapitullit kandidatet duhet të ketë të përfunduar shkollën e mesme të mjekësisë, drejtimi asistent i stomatologjisë.

Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet t'i paraqesin këto dokumente:

1. Kërkesën me biografi (CV) në gjuhën shqipe dhe angleze;
 2. Dëshmi mbi kualifikimin shkencor (Kopjen e diplomës përkatëse të noterizuar);
 3. Certifikatën e lindjes;
 4. Dëshminë se janë shtetas të Republikës së Kosovës;
 5. Dëshminë që nuk janë nën hetime ose nuk janë dënuar për ndonjë vepër penale tri vitet e fundit;
 6. Dëshmi mbi njohjen e gjuhës angleze, gjermane ose ndonjë gjuhë tjetër të huaj është përparësi për aplikantet.
- Kandidatët që kanë përfunduar studimet akademike jashtë vendit, duhet të sjellin dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT (Dëshmia duhet të jetë kopje e noterizuar).
 - Dokumentacioni i pa kompletuar dhe i dorëzuar pas afatit nuk do të merret në shqyrtim, dhe i njëjti mbetet në Kolegj.
 - Paraqitja e dokumenteve bëhet në Zyrën e Protokollit të Kolegjit UBT, Lagja; Kalabria, nr. p. n. – Prishtinë, Republika e Kosovës.
 - Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e komunikimit publik.

Rektori
Prof. Dr. Sc. Edmond Hajrizi

